



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**  
KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY  
**SHTIME / ŠTIMLJE**



|                         |                                                                                                |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Data/Datum/Date:        | 13.02.2025                                                                                     |
| Nr./Br./No              | 07/ 16                                                                                         |
| Për/Za/To:              | Kuvendi i Komunës së Shtimes                                                                   |
| Përmes/Preko/Through:   | Kryetarin të Komunës z.Qemajl Aliu                                                             |
| Nga/Od/From:            | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - znj. Mimoza Salihu<br>Qeriqi                  |
| Lënda/Predmet/Subject : | Propozim-Vendim për subvencionim Nënati-Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur |

Duke u bazuar në nenin 11, nenin 12.2 pika (d), nenin 17 pika (k), dhe nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/44 të datës 31.01.2024, për ndarjen e subvencioneve për nënat lehona për çdo fëmijë të lindur gjatë vitit aktual, si dhe për fëmijët e lindur në vitin paraprak e të cilët nuk kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesën për realizimin e të drejtës së tyre gjatë vitit paraprak, si vijon:

**I**

1. Femi i I-re do të subvencionohet 100 €
2. Femi i II-te do të subvencionohet 150 €
3. Femi i III-te e keshtu me radhe do të subvencionohet 200 €
4. Fëmijët binjak do të subvencionohen me 500 €
5. Fëmijët trenjak do të subvencionohen me 1000 €
6. Shumës prej 1000 € (për trinjakë) do t'i shtohen edhe nga 500 € për ç'do fëmijë të lindur njëkohësisht më shumë se trinjakë.

**II**

Të drejtën për aplikim e kanë edhe Nënati Lehona për fëmijët e lindur në vitin paraprak e që nuk kanë pas mundësi për arsye të ndryshme të aplikojnë. Por jo edhe të viteve të mëparshme për banorët e Komunës së Shtimes.

**III**

Të drejtën për aplikim sipas nenit -I- e kanë edhe Nënati Lehona që nuk e posedojnë shtetësinë e Kosovës por që janë të martuara me burrat që janë shtetas të Kosovës.

**III**

A r s y e t i m: Propozim-Vendimi për ndarjen e ndihmave për Nënati Lehona për fëmijë të lindur gjatë vitit aktual është propozuar për Kuvend duke marrë parasysh, zotimet tona për t'i ndihmuar kësaj kategorie.